

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje Uniforma ”

2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 3.000.000 (tre milion) lekë pa TVSH.

REF-20469-09-18-2024

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Rrogozhine, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes

së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise se shoqerise (QKB) tregtimin e mallrave objekt te kesaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit që prokurohet**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022-2023**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1 Furnizime të së njëjtes natyre në një vlerë 40% të fondit limit, që prokurohet të realizuara (nga subjekti juaj) në 3 vitet e fundit. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme.

- Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata dhe vërtetimi i realizimit ose faturat tatimore të shitjes, ndërsa furnizimet me subjektet private duhet të jenë të shoqëruara me fatura tatimore të shitjes të *konfirmuara nga blerësi dhe shitesit*, ku të përcaktohen qarte, sasitë, vlerat, nr dhe data e fatures.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4/b, për *procedurat e hapura të thjeshtuara* të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë: a) ISO 9001-2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik,

çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike mostrat/ kampionet e artikujve që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST ne përputhje me specifikimet teknike, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik detyrimisht duhet të paraqesin nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat, në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit referuar detajeve në shtojcën 5.

b) Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave (psh:Nr.1- Këmishë me mëngë të gjata, referuar preventivit/ shtojcës 2).

c) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve, Bashkia Rrogozhine, me Adresa: **Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori”**. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues. Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurave. Autoriteti kontraktor kur vëren dyshime i lind e drejta të verifikojë, të kërkojë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme. Mospajtueshmëria përbën kusht s’kualifikimi.

d) Logo zyrtare e Autoriteti Kontraktor qe duhet te perdoret ne te gjitha uniformat sipas **Vkm 406 date 19/06/2024**



Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia
1	Kostum uniforme(xhakete+Pantallona)	pale	1
2	Xhup blu I erret	cope	1
3	Pantallona verore	pale	1
4	Pantallona dimerore	pale	1
5	Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër	cope	1
6	Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër	cope	1
7	Kravate blu e erret	cope	1
8	Kapele tip sportive	cope	1
9	Embleme krahu	cope	1
10	Kepuce me qafa	pale	1
11	Kepuce gjysma verore M/F	pale	1
12	Pulovër blu e errët	cope	1
13	Bluze me minge te shkurtra	cope	1

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te beje dorezimin e mallit ne magazinën e Bashkisë Rrogozhinë, sipas preventivit dhe grafikut, qe do i bashkalidhet DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

Pasi u lexuan te githa dhe u miratua dokumentacioni , nga komisioni, Juristi eshte personi i autorizuar nga komisioni i hartimit te dokumentave qe do te ngarkoje DST dhe Argument , ne sistemin e APP.(www.app.gov.al)

Njesia e prokurimit: